

RAPORT I AVOKATIT TË POPULLIT DREJTUAR KOMITETIT PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR

To: Human Rights Council and Treaty Mechanisms Division
Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights
HCHR-Palais Wilson, 52 rue des Pâquis
CH -1211 Geneva 10
Switzerland

To : Catherinne I. Pedreros P. (Ms.)
Human Rights Officer
Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights
E-mail: cpedreros@ohchr.org
Tel: +41 22 917 9309
Fax: +41 22 917 9034

I. Shënime hyrëse

Sigurimi i mbrojtjes së posaçme të personave invalidë dhe kushtet e përfshirjes së tyre në jetën shoqërore është e drejtë e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë të vitit 1991, e që më vonë është implementuar përmes kompetencës dhe të drejtës për mbrojtjen e fëmijëve dhe të personave me aftësi të kufizuar (persona me nevoja të veçanta) të Avokatit të Popullit, në Ligjin për Avokatin e Popullit të vitit 2003, përkatësisht në mënyrë plotësuese përmes ndryshimeve të Ligjit përkatës të vitit 2009 dhe 2016. Së këtejmi, u parashikua mundësia e formimit të seksionit të veçantë i cili do të punoj në promovimin, parandalimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar, përkatësisht në monitorimin e respektimit dhe realizimit të të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar, të përcaktuara në marrëveshjet ndërkombëtare, ligjet dhe aktet nënligjore të Republikës së Maqedonisë.

Si institucion i cili ka praktikë shumëvjeçare në veprimin e pjesës së mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Avokati i Popullit përmes kësaj Informatë ka për qëllim të kontribuoj në drejtim të shqyrtimit të implementimit dhe zbatimit të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

Në Informatë i pasqyrojmë gjendjet e periudhës 2012-2017, të prezantuara në raportet vjetore të Avokatit të Popullit, përmes të dhënave statistikore për parashtrësat e pranuar dhe punës me lëndë në pjesën e mbrojtjes së të drejtave, më saktësisht numrin e procedurave të hapura për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar, kur të njëjtat u cenohen nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet e organizatat të cilat kanë autorizime publike.

Njëkohësisht, në Informatë janë prezantuar konstatimet nga monitorimi i gjendjeve të përgjithshme lidhur me të drejtat e fëmijëve, përkatësisht personave me aftësi të kufizuar dhe rrjedhimisht me këtë janë dhënë rekomandime nga Avokati i Popullit, të cilat janë pjesë përbërëse të Raporteve të posaçme dhe Informatave, pas zbatimit të hulumtimeve në periudhën e cekur. Në momentin e paraqitjes së kësaj Informatë, në përgatitje e sipër Raporti nga hulumtimi i zbatuar për përfshirjen (inkluzionin) e fëmijëve me aftësi të kufizuar në institucionet parashkollore, përkatësisht kopshtet e fëmijëve.

Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë sinqerisht shpreson se kjo Informatë do të ndihmojë në hartimin e raportit përfundimtar për Republikën e Maqedonisë lidhur me zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Invaliditet.¹ Po ashtu, Ju njoftojmë se informata plotësuese për punën e Avokatit të Popullit, përfshirë edhe Seksionin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar, mund të gjeni në ueb faqen tonë www.ombudsman.mk.

¹Terminologjia e cila përdoret për fëmijë/persona me aftësi të kufizuar është e ndryshme në tekstet e ligjeve, por edhe në Kushtetutë. Hasen më shumë nocione: aftësi të kufizuara, nevoja të veçanta, hendikep, invaliditet dhe ngjashëm. Avokati i Popullit e përdor nocionin fëmijë/persona me aftësi të kufizuar.

II. Për institucionin e Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit, në përputhje me Ligjin për Avokatin e Popullit, i kushton vëmendje të veçantë mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar, si dhe realizimit të të drejtave të tyre, të garantuara me Kushtetutë, ligje dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare. Dispozita ligjore konform të cilës “Republika u siguron mbrojtje të veçantë personave me invaliditet dhe kushte për përfshirjen e tyre në jetën shoqërore” është operacionalizuar në Ligjin për Avokatin e Popullit të vitit 2003 dhe më konkretisht në ndryshimet dhe plotësimin e këtij ligji në vitin 2009, përmes kompetencës së vendosur që Avokati i Popullit të siguroj mbrojtje të veçantë të të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar, përmes Seksionit të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe personave me nevoja të veçanta. Në përputhje me ndryshimet dhe plotësimin e Ligjit për Avokatin e Popullit si organ i Republikës së Maqedonisë i promovon dhe mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve dhe të të gjithë personave të tjerë (neni 2), përkatësisht kryen preventimin dhe sigurimin e mbrojtjes së veçantë të të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar (neni 11-b) të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Avokatin e Popullit (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 60/03,114/09,181/16,189/16,35/18) .

Është e nevojshme të përmendet se Avokati i Popullit vepron sipas parashtrësës së parashtruar nga ana e qytetarëve, e cila duhet t'i përmbaj rrethanat, faktet dhe provat mbi të cilat janë prezantuar të dhënat për cenimin e të drejtës, ndërsa njëkohësisht ai mund të veproj edhe me iniciativë të vet për cenimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të një numri më të madh të qytetarëve, personave të mitur, të pamundur, personave me nevoja të veçanta, për çka nuk nevojitet pëlqim nga personi/personat të drejtat e të cilëve janë cenuar. Gjatë paraqitjes së parashtrësë gjuha, në të cilën paraqitet parashtrësja, nuk përbën pengesë për komunikim me Avokatin e Popullit. Përkatësisht, me të mund të komunikohet përveç se në gjuhën dhe alfabetin zyrtar edhe në gjuhën dhe alfabetin e cilësdo qoftë bashkësi që jeton në Republikën e Maqedonisë, ndërsa Avokati i Popullit përgjigjet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik, si dhe në gjuhën dhe alfabetin zyrtar të cilin e ka përdorur parashtruesi i parashtrësës. Parashtrësja me të cilën iniciohet procedura nuk ka formë të caktuar, e njëjta mund të paraqitet me shkrim, gojarisht në procesverbal ose përmes rrugës elektronike.

Parashtruesi i parashtresës është i çliruar nga pagimi i taksave për procedurën para Avokatit të Popullit.

Nëse Avokati i Popullit gjatë veprimit përcakton dhe konstaton se me veprime ose akte të caktuara cenohen të drejtat e qytetarit ose se ekziston diskriminim mbi bazë të aftësisë së kufizuar ose mbi ndonjë bazë tjetër, mund të jep rekomandim, sugjerim, mendim dhe propozim deri te organet e administratës shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe deri te organet dhe organizatat me autorizime publike. Organet duhet t'i respektojnë rekomandimet, sugjerimet, mendimet dhe propozimet e Avokatit të Popullit, ndërsa nëse nuk respektohen Avokati i Popullit ka mundësi ligjore ta njoftoj ministrin kompetent, Qeverinë ose Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, me ç'rast në mënyrë plotësuese mund ta ekspozoj në kritikë publike çdo organ kompetent ose person zyrtarë i cili ka kryer cenimin e të drejtës së qytetarit.

Seksioni për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar, vepron konform kompetencave ligjore, përmes parashtrimit të parashtresave, gjatë mbrojtjes së të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve nga ana e organeve të administratës shtetërore, organizatave të cilat kanë autorizime publike, organeve të vetëqeverisjes lokale dhe institucioneve e shërbimeve publike. Njëkohësisht, Seksioni i promovon të drejtat dhe liritë e njeriut, dhe e sugjeron nevojën e mbrojtjes së tyre, zbaton hulumtime përkatëse, aktivitete edukative nëpër shkolla dhe institucione tjera për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuar. Përmes takimeve të drejtpërdrejta me fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuar dhe prindërit e tyre kontribuon për informimin dhe njoftimin më të madh me të drejtat, mënyrat dhe mekanizmat për mbrojtjen e tyre, përgatit, boton dhe bën distribuimin e broshurave dhe fletëpalosjeve që kanë të bëjnë me të drejtat e tyre, ndërsa merr pjesë edhe në konferenca, në vend dhe jashtë vendit, në të cilat shqyrtohen çështjet lidhur me realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar.

Në realizimin e kësaj që u tha më lartë, Seksioni për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar pranë Avokatit të Popullit bashkëpunon me sektorin civil, përkatësisht me një numër të madh të shoqatave qytetare, si dhe organizatave të tjera vendase dhe ndërkombëtare, përfshirë edhe institucionet e Ombudsmanit të rajonit dhe më

gjerë, të cilët punojnë në fushën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore të qytetarëve, përkatësisht të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar.

III. Përshkrimi i gjendjes

Avokati i Popullit në mënyrë aktive e monitoron veprimin e organeve kompetente sa u përket kërkesave të qytetarëve në lidhje me realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe personave me aftësi të kufizuar dhe për këtë arsye si kontribut për zgjidhjen e problemeve të kësaj kategorie vulnerable deri te ministritë kompetente dhe organet e tjera të administratës shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe institucionet dhe shërbimet publike për mbrojtjen dhe kujdesin e këtyre qytetarëve, i dërgon të gjitha hulumtimet dhe raportet nga aktivitetet e zbatuara të cilat kanë të bëjnë me fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuar në të cilat përveç gjendjeve të konstatuara, në fusha të ndryshme janë dhënë rekomandime dhe udhëzime për avancimin e statusit të tyre dhe integrimin adekuat në shoqëri.

Numri i vogël i parashtresave të parashtruara, nga fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuar pranë Avokatit të Popullit, e nxiti Avokatin e Popullit që t'i rishikoj gjendjet me realizimin e të drejtave të këtij grupi vulnerabil dhe të marginalizuar duke i marrë parasysh informacionet se pranimi i tyre, inkluzioni dhe grupi i marginalizuar në shoqëri nuk është në nivel të kënaqshëm. Ky konstatim i Avokatit të Popullit rezulton nga një numër i madh i hulumtimeve, monitorimi i gjendjeve në shoqëri, si dhe nga takimet me fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuar, prindërit e tyre dhe shoqatat qytetare të cilat punojnë me përkushtim me këtë grup të qytetarëve. Në këtë kontekst të dhënat statistikore² për parashtresat e parashtruara pranë Avokatit të Popullit gjatë periudhës kohore 2012-2017 tregojnë numër prej 60 parashtresave në të cilat parashtruesit në mënyrë eksplicite kanë kërkuar mbrojtje si persona me aftësi të kufizuar, ndërsa nga përmbajtja e të njëjtave janë të pakontestueshme konstatime se problemet kanë të bëjnë me një numër më të madh të qytetarëve të cilët janë me aftësi të kufizuar të njëjtë. Në lidhje me numrin e parashtresave të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve, në mesin e të cilave edhe për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuar,

² Raporte vjetore të Avokatit të Popullit për nivelin e sigurimit të respektimit, avancimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut 2012- 2017, www.ombudsman.mk

numri i përgjithshëm i parashtresave në periudhën kohore 2012-2017 është 784, për mbrojtjen e të drejtave nga sfera të ndryshme.

Sa i përket punës me lëndë, Avokati i Popullit vazhdimisht e vë në dukje ndalimin e diskriminimit mbi çdo bazë, përfshirë edhe mbi bazë të aftësisë së kufizuar, duke u thirrur në legjislacionin vendas dhe ndërkombëtar, duke sugjeruar se nuk ka progres të dukshëm në realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar dhe inkluzionin e tyre në shoqëri. Njëherësh, mungon qasja multidisiplinare dhe bashkëpunimi ndërsektorial për përmirësimin e qasjes dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar në më shumë fusha, ndërkohë që akoma janë të pranishëm edhe stereotipat dhe paragjykimet tek të tjerët ndaj kësaj kategorie të qytetarëve, e që i bënë akoma më vulnerabil dhe të lënë në margjinat e shoqërisë.

Neni 5, 6 dhe 7: Barazia dhe mosdiskriminimi/ Gra me aftësi të kufizuar/Fëmijë me aftësi të kufizuar

E drejta e barazisë dhe ndalimi i diskriminimit, të garantuara me Kushtetutë, janë operacionalizuar në Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi i cili, në nenin 3 – Bazat e diskriminimit, ndalon çdo diskriminim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, nxitje të diskriminimit dhe ndihmë në veprimin diskriminues, mes tjerash, edhe mbi bazë të gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar ose cilësdo qoftë baze tjetër që është parashikuar me Ligj ose me marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare.

Të drejtat e grave/vajzave me aftësi të kufizuar, përkatësisht mundësitë e tyre nuk janë rregulluar me dispozita të posaçme në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, gjithashtu, nuk janë rregulluar as me zgjidhjet e tjera ligjore, në të cilat parashikohet parimi i ndalimit të diskriminimit, ndërsa me Strategjinë nacionale për barazi dhe mosdiskriminim mbi bazë të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar mendore dhe trupore 2005-2015 në mënyrë strategjike shteti orientohet për realizimin e të drejtës së barazisë dhe krijimin e mundësive të barabarta. Megjithatë, në praktikë, garancia e mosdiskriminimit ndaj fëmijëve dhe grave me aftësi të kufizuar është më shumë deklarative, e që është edhe konstatim i prindërve/kujdestarëve të fëmijëve me aftësi të kufizuar nga takimet e drejtpërdrejta me Avokatin e Popullit.

Së këtejmi, perceptimi i prindërve/kujdestarëve të fëmijëve/personave me aftësi të kufizuar është se vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuar diskriminimin e ndjejnë në disa nivele: në bazë të përkatësisë së tyre gjinore, aftësisë së kufizuar dhe përkatësisë etnike. Në këtë kontekst, nevojiten aktivitete të vazhdueshme në këtë fushë dhe afirmim të mekanizmave për mbrojtje nga diskriminimi, si dhe masa dhe aktivitete për përfshirje më të madhe të vetë fëmijëve/personave me aftësi të kufizuar dhe prindërve/kujdestarëve të tyre, me qëllim të tejkalimit të paragjyqimeve dhe vështirësive për qasje papengesë dhe realizimit të të drejtave në fusha të ndryshme, përkatësisht për trajtimin e tyre të barabartë me të tjerët.

Gjatë vitit 2017 prindërit e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar, përmes protestave të qeta kërkuan ndryshime dhe plotësime të kornizës ligjore dhe nënligjore për personat me aftësi të kufizuar, ndërsa Avokati i Popullit për rastin hapi procedurë me iniciativë të vet³. Po ashtu, deri te ministri i Arsimit dhe Shkencës, ministri i Punës dhe Politikës Sociale dhe ministri i Shëndetësisë paraqiti mendim se duhet të shqyrtohen seriozisht kërkesat e prindërve të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e realizimit të të drejtave të mbrojtjes sociale, arsimin, mbrojtjen shëndetësore dhe sigurimin, përmes ndryshimeve dhe plotësimeve të kornizës ligjore dhe nënligjore, me qëllim të krijimit të kushteve për realizimin e të drejtave, pa diskriminim, si qytetarë të këtij shteti.

Avokati i Popullit kërkoi të sigurohen kushte për gëzimin e plotë të të drejtave dhe lirive të fëmijëve/personave me aftësi të kufizuar, dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë në shoqëri, masa për sigurimin e qasjes dhe aksesit deri te mjedisi kulturor, fizik, social dhe ekonomik, si dhe qasjes deri te shërbimet në shëndetësi, arsim, përkatësisht deri te informatat e nevojshme, me qëllim që t'u mundësohet tërësisht t'i gëzojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, me çka dukshëm do të kontribuohet për kompensimin e padrejtësive sociale dhe të tjera të këtyre personave në shoqëri.

³ AP nr. 1012/17, lëndë e hapur me iniciativë të Avokatit të Popullit

Neni 8 – Ngritja e vetëdijes

Seksioni për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar pranë Avokatit të Popullit, me qëllim që t'i promovoj të drejtat e këtyre qytetarëve, t'i informoj për institucionin Avokat i Popullit, mandatin, rolin dhe kompetencën e këtij organi, dhe ti njoftoj me mënyrat se si t'i drejtohen, si dhe t'i dëgjoj mendimet e këtij grupi të qytetarëve për të drejtat në sfera të ndryshme të jetës shoqërore, në periudhën mars-prill 2016 realizoi takime edukative dhe promocionale me fëmijët/personat me aftësi të kufizuar dhe prindërit/kujdestarët e tyre, përkatësisht Shoqatat e personave me aftësi të kufizuar⁴. Takimi i parë informativ u mbajt në mars të vitit 2016 në ambientet e “Dare Xhambaz” – Shkup, me kryetarët e më shumë organizatave dhe trupave për persona me aftësi të kufizuar, edhe atë: “Këshilli nacional i organizatave të invalidëve të Maqedonisë”, “Lidhja nacionale e të verbërve të Republikës së Maqedonisë”, “Lidhja nacionale e të shurdhëve dhe pjesërisht të shurdhërve të Republikës së Maqedonisë”, Lidhja Nacionale e personave me invaliditet trupor të Maqedonisë – Mobilitet Maqedoni”, “Qendra republikane për mbështetjen e personave me aftësi të kufizuar intelektuale-Poraka”, “Lidhja nacionale e invalidëve civil të luftës të Maqedonisë”, “Federata nacionale për sport dhe rekreacion të invalidëve të Maqedonisë-Komiteti maqedonas paraolimpik” dhe “Lidhja nacionale e invalidëve të punës të Republikës së Maqedonisë”. Pas këtij takimi, u realizuan takime me prindërit e fëmijëve dhe personave me paralizë cerebrale, me prindërit e fëmijëve me Sindromin Daun anëtarë të Shoqatës “Trisomnia 21”, prindër fëmijët e të cilëve e vizitojnë Qendrën ditore për fëmijë me aftësi të kufizuar intelektuale “Poraka” – Shkup, si dhe anëtarëve të Shoqatës për të verbër dhe pjesërisht të verbër të Qytetit të Shkupit.

Kjo iniciativë e Avokatit të Popullit për takime me prindërit e fëmijëve/personave me aftësi të kufizuar, në të cilat morën pjesë edhe persona me lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar, u përshëndet dhe u vlerësua pozitivisht si mundësi që haptazi t'i paraqesin

⁴ Informata për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuar (fëmijë dhe persona me Paralizë Cerebrale, Sindromën Daun, aftësi të kufizuar intelektuale, persona të verbër dhe pjesërisht të verbër), nga perspektiva e fëmijëve/personave me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre, gusht 2016, Raporte të posaçme www.ombudsman.mk

perceptimet për vështirësitë me të cilat ballafaqohen në qasjen deri te të drejtat dhe për trajtimin e të tjerëve.

Të gjithë, njëzëri ranë dakord se personat me aftësi të kufizuar pavarësisht nëse emërohen si “persona me aftësi të kufizuar”, “persona me hendikep” ose “persona me invaliditet” edhe më tej janë në margjinat e shoqërisë, me ç’rast për çdo ditë janë në luftë për të dëshmuar se nevojat e tyre duhet të merren parasysh në kontekst të të drejtave dhe lirive të njeriut. Në këtë aspekt, propozoi që organet kompetente përmes fushatave të vazhdueshme, tryezave të rrumbullakëta ose llojeve të tjera të aktiviteteve të kontribuojnë për promovimin e të drejtave, përforsimin e vetëdijes për nevojat e qasjes së barabartë deri te të drejtat e kësaj kategorie të qytetarëve.

Në këtë kontekst, prishmëritë dhe kërkesat e prindërve të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar nuk janë asgjë më shumë se ngritja e vetëdijes për ekzistimin e tyre dhe zgjidhjen e domosdoshme të problemeve, promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe sigurimin e kushteve për gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut të cilat nuk janë privilegj. Po ashtu, nevojitet edhe perceptimi i personave me aftësi të kufizuar dhe përfshirja e tyre aktive si qytetarë të kësaj shoqërie, të cilët kanë të drejtë të barabartë sikurse edhe të tjetër, të drejtë të jetës, krijimit të familjes dhe rritjes e fëmijëve të tyre, të drejtë të arsimimit dhe punës, pjesëmarrje në jetën sociale... për çka nevojitet krijimi i mjedisit jetësor pa barriera dhe inkurajimi që të jetojnë të pavarur, duke kontribuar në çdo aspekt në shoqëri, duke e marrë parasysh dinjitetin e barabartë dhe vlerën e çdo qenie njerëzore.

Neni 9 – Qasja

Realizimi i të drejtës së personave me aftësi të kufizuar dhe me vështirësi, si në qasjen deri në shërbimet, ashtu edhe gjatë qasjes në objekte të caktuara. Mjedisi fizik akoma nuk është mjaftueshëm i aksesshëm për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuar. Numri më i madh i rrugëve, mjeteve të transportit dhe institucioneve publike nuk janë të aksesshme për personat me aftësi të kufizuar, ndërsa për shkak të barrierave arkitektonike, në mjedisin në të cilin jetojnë, e kanë të pamundur të lëvizin pa shoqërimin e një personi tjetër por, gjithashtu, e kanë të pamundur të shfrytëzojnë transport falas nëse nuk dërgojnë mendim konsiliar edhe për shoqëruesin e tyre.

Avokati i Popullit, e përshëndet vendosjen e traseve ndihmëse të cilat do ta lehtësojnë dukshëm lëvizjen e personave, me çka do të jenë funksional edhe personat e verbër të cilët do të mundën vetë, në mënyrë më të lehtë t'i kryejnë detyrat e tyre, si dhe kontribuohet edhe në integrimin e tyre në shoqëri.

Për fëmijët me aftësi të kufizuar janë krijuar fusha sporti inkluzive në disa komuna dhe rekomandimi është që të vazhdoj ndërtimi i vendeve të këtilla për rekreacionin e fëmijëve me aftësi të kufizuar në më shumë komuna.

Në “Gazetën zyrtare të RM” me nr. 6/2016” është miratuar Programi për refundimin e mjeteve të paguara si të dhëna doganore, tatim mbi vlerën e shtuar dhe akcizë për furnizimin e automjetit për persona me më së paku 80% invaliditet në ekstremitetet e poshtme, persona me aftësi të kufizuar mesatare, të rëndë dhe të thellë intelektuale, për persona tërësisht të verbër me shoqërues dhe për persona tërësisht të shurdhër për vitin 2016.

Avokati i Popullit, nga veprimi praktik sipas parashtrësive të parashtruara konstatoi se prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar, të cilët lëvizin me ndihmën e karrocës për invalidë, në përputhje me nevojat e fëmijëve, detyrohen që në mënyrë shtesë të instalojnë elemente në automjet të cilin e përdorin ekskluzivisht për nevojat e fëmijëve të tyre, përkatësisht të kryejnë përshtatjen e automjetit për transport të sigurt (instalimin e rampës dhe rripave përkatës). Megjithatë, për këto instalime, ndonëse në mënyrë plotësuese i paguajnë me mjete personale, nuk u miratohet refundimi, në përputhje me programin e lartpërmendur, me të cilin jepet mundësia e refundimit të mjeteve të paguara si tatime doganore për furnizimin e automjetit për udhëtim. Së këtëjmi, refuzimin e kërkesave, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale e justifikon me arsyetimin se automjeti i siguar për udhëtim është me vlerë më të lartë se 10.000,00 euro me kundërvlerë në denarë, me çka nuk plotësohen kushtet e nenit 213-a të Ligjit për mbrojtje sociale, si dhe kriteret e Programit për refundimin e mjeteve të paguara si tatime doganore, tatim mbi vlerën e shtuar dhe akcizë për furnizimin e automobilit për udhëtim, i cili ka të bëjë me personat me më së paku 80% invaliditet të ekstremiteteve të poshtme, personat me aftësi të kufizuar të mesatare, të rëndë dhe të thellë intelektual, për personat tërësisht të verbër me shoqërues dhe për personat tërësisht të shurdhër. Prindërit e këtyre fëmijëve e njoftuan Avokatin e Popullit se në tregun e automobilave nuk ka makinë që kushton deri në

10,000 euro, e që i plotëson kriteret për transportin e personit në karrocë invaliditeti, si dhe kulmi i automjetit duhet të ketë minimalisht lartësi prej 140 cm, e që në njëfarë mënyre i obligon prindërit të gjejnë automjet i cili është konform këtyre kriterëve për përdorim të sigurt dhe për sigurimin e nevojave të fëmijëve në karrocë invaliditeti.

Së këtejmi, rezulton se me nenin 213-a të Ligjit kufizohet shuma gjatë furnizimit të automjetit (deri në 10,000 euro), me ç'rast nuk janë marrë parasysh shumat reale për furnizimin e automjetit me të cilin transportohet fëmija/personi me karrocë invaliditeti, ndërsa për këtë shumë mund të blihet automjet me të cilin transportohet personi me aftësi të kufizuar tjetër, i cili është i lëvizshëm. Avokati i Popullit, duke e pasur parasysh këtë që u tha më lartë dhe duke u udhëhequr nga Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, kërkoi nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të zbatoj hulumtim në tregun e automjeteve dhe ta konstatoj gjendjen faktike, si dhe ta shqyrtoj mundësinë e ndërmarrjes së masave në drejtim të korrigjimit të kriterit prej 10,000 euro me kundërvlerë në denarë për automjetin me të cilin do të transportohen personat në karrocë invaliditeti, por edhe limitin prej maksimum mjeteve të refunduara prej 180,000 den. për automjet të blerë.

Gjithashtu, vuri në dukje se automjetet të cilët kanë të bëjnë me nevojat e fëmijëve në karroca invaliditeti si udhëtarë u nevojitet ripërpunim i cili paguhet shtesë, me çka do të mundësohet që fëmija në karrocë të futet në automjet (me instalimin e rampës, ashensorit dhe ngjashëm) dhe rripa përkatës (ose ngjashëm) për përforcimin e karrocës por edhe rripa përkatës (breza) me qëllim që të mund të transportohet në mënyrë të sigurt, dhe propozoi që Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ta shqyrtoj mundësinë për refundimin e plotë të mjeteve, e që do të thotë ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtje sociale.

Duke pasur parasysh të drejtën e qasjes, Avokati i Popullit u sugjeroi organeve kompetente se është e nevojshme të respektohen dhe në mënyrë konsekuente të zbatohen dispozitat ligjore, me qëllim që çdo person me aftësi të kufizuar të mund të lëvizë papengesë dhe të orientohet në hapësirës, përmes sigurimit të rampave, ashensorëve, sinjalizimit me zë dhe me dritë, trotualet adekuat dhe ngjashëm, si dhe marrjen e masave për përshtatjen e autobusëve me rampa të aksesshme për personat me invaliditet trupor, me qëllim të qasjes më të lehtë deri te mjetet e transportit publik të këtyre personave.

Krahas kësaj, duke e marrë parasysh se nuk është zgjidhur plotësisht çështja e qasjes në informata të cilat në mënyrë dhe format të lehtë duhet të jenë të kuptueshme, në përputhje me aftësinë e kufizuar të personave, Avokati i Popullit e potencoi rolin e mediave në ngritjen e vetëdijes publike, përmes informimit të personave me aftësi të kufizuar duke e respektuar dinjitetin e këtyre personave, si dhe angazhimin e organeve/institucioneve të nivelit qendror dhe lokal për ndërmarrjen e aksioneve konkrete për informimin e personave me aftësi të kufizuar, por edhe të publikut për të drejtat dhe nevojat e këtyre personave, respektimin e të drejtave dhe vetëdijes më të madhe sociale për ekzistimin e tyre dhe nevojën për inkluzion të çdo lloji.

Po ashtu, në Raport, pas zbatimit të hulumtimit nga ana e Avokatit të Popullit⁵ të cilin e zbatoi gjatë vitit 2017, në aspekt të qasjes në shkolla, u konstatua se Shkollat e mesme publike nuk i plotësojnë kushtet e nevojshme për sigurimin e qasjes fizike. Përkatësisht, analiza nga të dhënat e pranuar nga 92 prej 107 shkollave të mesme tregoi se në 55 shkolla të mesme (53%) ka rampë për qasje në hyrje të objektit shkollor, 15 (14%) ka klasa të përshtatura dhe hapësira të tjera të brendshme, por asnjëra nuk ka ashensor të jashtëm në hyrje të objektit shkollor, ndërsa vetëm 13 (13%) kanë tualete të përshtatura (të aksesshme). Më tutje, 2 shkolla (2%) kanë instaluar ashensorë të brendshëm për lëvizje midis kateve, 15 (14%) janë përgjigjur se në këtë drejtim nuk janë ndërmarrë masa të veçanta, ndërsa 4 (4%) janë përgjigjur të tjera, pa cekur konkretisht se me çka kanë të bëjnë.

Nga vizitat e drejtpërdrejta vërejtëm se, kur bëhet fjalë për qasje, e aksesshme është hyrja në shkollë, por jo edhe pjesa e brendshme. Ndonëse ekziston rampë e aksesshme në hyrje, ndodhë që e njëjta të mos jetë në dobi të nxënësve, sepse nuk i plotëson dhe respekton standardet për qasje. Së këtejmi, nxënësit të cilët përdorin karrocë kanë nevojë për mbështetje të cilën në të shumtën e rasteve e sigurojnë prindërit e tyre.

Qasja deri te tualeti, si koncept, në shumë shkolla nuk është i njohur mjaftueshëm. Përshtatja përbëhet nga montimi i WC guacës, ndërsa numri më i madh i toaleteve në shkolla janë me “të ulur”. Mosekzistimi i toaletit të aksesshëm e vështirëson qëndrimin e nxënësve në

⁵ Përfshirja e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuar në arsimin e mesëm të rregullt, Raport nga hulumtimi, dhjetor 2017, Raporte të posaçme, www.ombudsman.mk

shkollë dhe e imponon nevojën e përfshirjes së prindërit, ose mbajtjen “prevenim” në mënyrë që fëmija të mund të qëndroj i ulur në të gjitha orët.

Adaptimi më i shpeshtë, kur bëhet fjalë për qasje fizike, të cilën e sigurojnë shkollat është qëndrimi në të gjitha orët në klasën që gjendet në katin përdhes.

Gjendja është akoma më e pafavorshme kur bëhet fjalë për pasjen në dispozicion të pajisjeve të aksesshme (të përshtatura) pedagogjike-didaktike dhe mjeteve mësimore. Po ashtu, 74 shkolla (80%) nuk disponojnë me pajisje të këtyre të cilat e lehtëson përfshirjen aktive të nxënësve me aftësi të kufizuara, 12 shkolla (13%) janë përgjigjur se kanë në dispozicion materiale të përshtatura didaktike. Më së shpeshti ato janë shkolla në të cilat defektologët përgatisin materiale me dedikim për punë individuale me nxënësit, përkatësisht ato janë shkolla, në qendrat karriere të të cilave është siguruar teknologjia informatike e asistuar.

Neni 12 – Njohja e barabartë para ligjit

Sipas Kushtetutës së RM⁶ qytetarët janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjeve, ndërsa me operacionalizimin e kësaj dispozite kushtetuese në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, në mënyrë eksplicite ndalohet diskriminimi mbi bazë të aftësisë së kufizuar (aftësi e kufizuar mendore dhe trupore) të qytetarëve.

Avokati i Popullit, duke e monitoruar gjendjen me realizimin e të drejtës së arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin fillor dhe të mesëm, pakontestueshëm konstaton se aktet kryesore – Ligji për arsim fillor⁷ dhe Ligji për arsim të mesëm⁸ në mënyrë eksplicite e ndalojnë diskriminimin mbi bazë të: gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes nacionale dhe sociale, besimit dhe bindjes fetare, pozitës pronësore dhe shoqërore, por nuk e parashikojnë aftësinë e kufizuar si bazë për diskriminim.

Analiza e kornizës ligjore e cila e rregullon të drejtën e arsimimit, nga aspekti i barazisë para ligjeve tregon se neni 33, paragrafi 1 i Ligjit për arsim të mesëm, siguron të drejtën e regjistrimit në shkollë të mesme të gjimnazit sigurohet për “nxënësit e rregullt të cilët e kanë

⁶ Neni 9 i Kushtetutës së RM

⁷ Neni 2 paragrafi 2 i Ligjit për arsimin fillor

⁸ Neni 3 paragrafi 3 i Ligjit për arsim të mesëm

kryer arsimin fillor”; nga ana tjetër, neni 34, paragrafi 1, siguron të drejtën e regjistrimit në shkollë të mesme profesionale për “nxënës të rregullt dhe me korrespondencë të cilët e kanë kryer arsimin fillor”. Nxënësit me aftësi të kufizuar nuk janë përmendur fare në dispozitat të cilat kanë të bëjnë me regjistrimin e nxënësve në arsimin e mesëm të rregullt.

Së këtejmi, neni 39, paragrafi 1, parashikon se “në arsimin e mesëm për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, nxënësit arsimohen sipas programeve arsimore për profesione përkatëse, përkatësisht profile arsimore ose për aftësim për punë”. Në mënyrë plotësuese, neni 40, paragrafi 1, parashikon se “në arsimin e mesëm për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore përfshihen nxënësit të cilët janë evidentuar dhe sistematizuar sipas llojit dhe nivelit të aftësive të kufizuara në zhvillim”.

Kur këto dy dispozitat do të shihen bashkë duket se fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuar, të cilët kanë dokumentacion përkatës për aftësinë e kufizuar të tyre referohen në shkollat e posaçme të mesme. Nëse merret parasysh se arsimi i posaçëm i mesëm i aftëson nxënësit vet për një numër të kufizuar të profesioneve, një gjë e këtillë mund të konsiderohet se këto zgjidhje e stimulojnë segracionin e nxënësve me aftësi të kufizuar, duke i reduktuar mundësitë që këta nxënës, në një të ardhme, të sigurojnë punësim në tregun e hapur të punës. Së këtejmi, nevojiten përmirësime në dy drejtime – fëmijët me aftësi të kufizuar të cilët në mënyrë më masive regjistrohen në arsimin e rregullt, gjithashtu, nënkupton nevojë për program më të diferencuar arsimor, ndërsa nga ana tjetër nevojitet edhe modernizim i planeve mësimore dhe programeve arsimore sipas së cilëve zbatohet mësimi në shkollat e posaçme.

Në Ligjin për tekstet shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm⁹ parashikohet se libri është mjeti kryesor mësimor dhe burim i dijeve për realizimin e qëllimeve edukative-arsimore të përcaktuara në planin dhe programin mësimor për arsimin fillor dhe të mesëm. Në asnjë nen të Ligjit nuk parashikohet se tekstet shkollore duhet të përpilohen edhe në format i cili do të jetë i aksesshëm për të gjithë nxënësit, përfshirë edhe tekstet elektronike shkollore në format të aksesshëm, tekstet shkollore të alfabetin të Brail-it, librat që lexohen lehtë, dhe ngjashëm,

⁹ Neni 2 i Ligjit për tekstet shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 98/2008, 99/2009, 83/2010, 36/2011, 135/2011, 46/2012, 24/2013, 120/2013, 29/2014, 146/2015, 217/2015 dhe 30/2016)

konform nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuar. Në Ligjin për arsim profesional¹⁰, në asnjë nen nuk është theksuar se nxënësit me aftësi të kufizuar kanë të drejtën e arsimit profesional dhe trajnimit apo se duhet të merret parasysh përshtatja sa i përket qasjes fizike në objektet e arsimit profesional dhe trajnimit, përgatitjes së planeve individuale arsimore për arsim profesional dhe trajnim, qasjes në materialet për mësim ose pajisjeve të përshtatura për mbrojtje gjatë punës. Edhe në Ligjin për standardin e nxënësve,¹¹ veçanërisht në nenet të cilët kanë të bëjnë me konviktet e nxënësve, përshtypja është se bëhet fjalë për konvikte të nxënësve për nxënës me aftësi të kufizuar dhe konvikte të nxënësve për nxënësi e tjerë. Nuk ka dispozita në të cilat theksohet se konviktet e nxënësve duhet të jenë të aksesshëm, të kenë së paku një ose dy dhoma të aksesshme ku do të mund të qëndrojnë nxënësit me aftësi të kufizuar, si dhe toalete të aksesshëm.

Nga puna e Avokatit të Popullit, pas paraqitjes së parashtresave në lidhje me barazinë para ligjeve, sa i përket qasjes deri në shërbime siç janë bankat, rezulton se numri më i madh i bankave nuk kanë siguruar qasje deri te shfrytëzimi i shërbimit, përkatësisht me plotësimin e formularit, personat të cilët janë të verbër dhe pjesërisht të verbër mund të kryejnë transaksione të caktuara ose lloj tjetër të shërbimeve financiare. Megjithatë, gjatë bisedës me këta persona janë marrë informata se faksimili të cilin e përdorin si “dora vet” nuk pranohet çdoherë nga ana e institucioneve si i besueshëm – rrethanë të cilën e vlerësojnë si qasje të pabarabartë dhe pengesë për realizimin e të drejtave të tyre, të garantuara me ligj.

Duke e monitoruar gjendjen me realizimin e të drejtës së zgjedhjes të personave me aftësi të kufizuar, nga aspekti i barazisë para ligjeve, Avokati i Popullit konstatoi se personat me aftësi të kufizuar nuk mund ta realizojnë plotësisht këtë të drejtë, pikë së pari për shkak të pamundësisë për të hyrë në vendvotimin e tyre, në objektet të cilat janë pa ashensorë dhe që janë në kat më të lartë. Mungon infrastruktura adekuate dhe rampa për personat në karroca invaliditeti, ndërkaq problem vërehet edhe në paravanin e pa përshtatshëm dhe kutinë e votimit, të cilat për personat me karrocë invaliditeti janë vendosur shumë lartë. Për shkak të pamundësisë që në mënyrë të pavarur ta realizojnë të drejtën e zgjedhjes, perceptimi i

¹⁰ Ligji për arsim profesional dhe trajnim (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 71/2006, 117/2008, 148/2009, 17/2011, 24/2013, 137/2013, 41/2014, 145/2015 dhe 55/2016).

¹¹ Ligji për standardin e nxënësve (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 52/2005, 117/2008, 17/2011, 135/2011, 15/2013, 41/2014, 146/2015 dhe 30/2016)

personave me aftësi të kufizuar është se nuk janë njësoj të barabartë para ligjit, përkatësisht se ndihen të diskriminuar nga ana e shtetit.

Avokati i Popullit konstaton se lista e zgjedhësve dhe fletëvotimi nuk janë përshtatur me alfabetin e Brail-it, si dhe nuk ekziston mënyra elektronike e votimit për personat e verbër të cilët nuk e dinë alfabetin e Brail-it, ndërkaq Ueb-faqja e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve nuk mundëson që përmes audio-regjistrimit, këta persona të informohen dhe të marrin informata konkrete të cilat do të ndihmonin që ta realizojnë të drejtën e tyre të votimit.

Avokati i Popullit i përshëndet angazhimet e shtetit për miratimin e Udhëzimeve të cilët burojnë nga neni 112-a të Kodit Zgjedhor, me aktet nënligjore të të cilave Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve për zgjedhësit – personat me aftësi të kufizuar, bëri përpjekje të gjejë mënyrë dhe t'u mundësoj qasje të barabartë deri te vendet e votimit, megjithatë, konstatimi është se nuk është instaluar sistem për qasje të barabartë për të gjithë qytetarët deri te vendet e votimit.

Avokati i Popullit Rekomandoi që Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, si trup dhe organ i pavarur i cili është më i thirruri dhe më përgjegjësi gjatë zbatimit të procesit zgjedhor, të ndërmerri masa në drejtim të zgjidhjes infrastrukture të problemit, para së gjithash, sepse votimi zhvillohet në objekte të cilat janë me karakter publik (shkolla, komuna dhe ngjashëm), përkatësisht objekte të cilat detyrimisht duhet t'i plotësojnë të gjitha standardet e qasjes së personave me aftësi të kufizuar. Njëherësh, rekomandoi që në çdo vendvotim të sigurohet minimum nga një paravan i cili do të ishte përshtatur dhe dedikuar për personat me karroca invaliditeti, dhe të parashikohet lartësia adekuate e vendosjes së kutive të votimit, para së gjithash, për shkak se lartësia e kutive mund të jetë problem edhe për personat të cilët kanë probleme tjera shëndetësore ose probleme të lindjes (rritje e ulët, probleme me kurrizin etj.).

Në drejtim të trajtimit të barabartë dhe mbrojtjes nga diskriminimi, Avokati i Popullit i rekomandoi Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve të propozoj ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit me mundësimin e votimit elektronik të personave me shikim të dëmtuar, si dhe ndryshimin e Ueb faqes së KSHZ e cila do të jetë e aksesshme për personat e verbër dhe personat me shikim të dëmtuar me vendosjen e aplikacionit të veçantë i cili është adekuat për personat të cilët kanë aftësi të këtillë të kufizuar.

Për arsye se rekomandimet e dërguara të Avokatit të Popullit nuk u zbatuan dhe respektuan nga Komisioni Shtetëror i zgjedhjeve, në përputhje me kompetencat ligjore u dërgua Informatë deri te Qeveria e Republikës së Maqedonisë në të cilën i potencuam zgjidhjet e rekomanduara për ndryshimin e Udhëzimeve konkrete të cilat rezultojnë nga neni 112-a i Kodit Zgjedhor.

Neni 13 – Qasja në drejtësi

Avokati i Popullit në vitin 2013, me qëllim të realizimit të së drejtës për interpretues në procedurat para organeve dhe institucioneve i sugjeroi Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale në mënyrë konsekuente ta respektoj të drejtën e sigurimit të interpretuesit, dhe të ndërmer masa për rritjen e numrit të njohësve të gjuhës së shenjave, me çka do të thjeshtëzohet qasja e këtyre personave në institucione të ndryshme të sistemit. Në këtë periudhë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale informoi për regjistrimin e interpretuesve të licencuar të gjuhës së shenjave në nivel të RM të cilët personat e shurdhër mund t'i angazhojnë për nevojat e tyre personale, por edhe gjatë komunikimit me institucionet relevante, në bazë të aktvendimit të miratuar nga ana e Qendrës për Punë Sociale, me të cilin personit të shurdhur i njihet e drejta e interpretuesit. Në drejtim të rritjes së vazhdueshme të numrit të interpretuesve të licencuar të gjuhës së shenjave për vitin 2014 ishin siguruar mjete plotësuese për organizimin e trajnimeve të gjuhës së shenjave, në kuadër të aktiviteteve ekzistuese programore të Lidhjes nacionale të shurdhërve dhe pjesërisht të shurdhërve të Maqedonisë dhe Komisionit për gjuhën e shenjave, si dhe se për 120 farmacistë ishte organizuar niveli fillestar i trajnimit për komunikim elementar në më shumë qytete të shtetit, për çka në Buxhetin e Ministrisë janë siguruar mjete shtesë.

Neni 19 – Jeta e pavarur dhe përfshirja në komunitet

Gjatë periudhës kohore 2012-2016, Avokati i Popullit duke vepruar si Mekanizëm Parandalues Nacional realizoi vizita të rregullta dhe për rikontroll në Entin Special Demir Kapi. Konfrom Statutit, veprimtaria kryesore e institucionit është vendosja e personave me pengesa në zhvillimin mendor, vendosja, përkujdesja, mbrojtja shëndetësore, rehabilitimi, terapia e punës dhe terapia okupacionale, në përputhje me aftësinë e shfrytëzuesve dhe gjendjen shëndetësore. Vizitat janë realizuar më datë 20.12.2012 (vizita e parë e rregullt e

paparalajmëruar), 28.11.2013 (vizita e paparalajmëruar për rikontroll) dhe vizita e datës 23-27.06.2016 (vizita e paparalajmëruar).

Gjatë vizitës së rregullt të paparalajmëruar është konstatuar numër prej 240 shfrytëzuesve me pengesa të rënda dhe shumë të rënda në zhvillimin fizik dhe mendor, në vitin 2013 gjatë vizitës së paparalajmëruar për rikontroll ky numër ka qenë 262 shfrytëzues me pengesa të rënda dhe shumë të rënda në zhvillimin fizik dhe mendor, ndërsa gjatë vizitës së tretë të realizuar në këtë Ent janë evidentuar 227 shfrytëzues. Së këtejmi, gjatë vizitës së parë të rregullt të realizuar në vitin 2012, si dhe gjatë vizitës për rikontroll në vitin 2013 u konstatua se kushtet materiale dhe gjendjet nuk i kënaqin standardet e dëshiruara sa i përket mirëmbajtjes së vazhdueshme të higjienës në hapësira. Larja e shfrytëzuesve bëhet nga ana e personave të gjinisë së kundërt, e që nuk ka ndryshuar as gjatë vizitës për rikontroll kur u konstatua se ndonëse në institucion ka edukatorë meshkuj, megjithatë, shfrytëzuesit me sëmundje më të rënda lahen edhe nga edukatoret femra.

Avokati i Popullit – MPN konstatoi se vetëm një numri të vogël të shfrytëzuesve u është hequr aftësia e punës dhe në mënyrë përkatëse u është caktuar kujdestari dhe për këtë rekomandoi të bëhet vlerësim i detajuar i gjendjes dhe në mënyrë përkatëse të hapen procedura për heqjen e aftësisë së punës dhe caktimin e kujdestarëve për të gjithë shfrytëzuesit ku realisht ekziston nevojë e këtillë. Vizita për rikontroll tregoi se ky rekomandim pjesërisht është zbatuar, duke e marrë parasysh se edhe krahas asaj se janë bërë përpjekje për caktimin e kujdestarëve nga ana e QPS, megjithatë, në Ent nuk ka të punësuar punëtorë social. Përveç kësaj, Avokati i Popullit rekomandoi sigurimin e sasisë së mjaftueshme dhe shumëllojshmërinë e ushqimit dhe vakteve për shfrytëzuesit, përfshirë edhe për personat e sëmurë me diabet me terapi të insulinës për të cilët nuk është parashikuar regjimi i ushqimit.

Prezenca dhe vizita e bashkëpunëtorëve të jashtëm (gjinekologë, internistë dhe fiziatër) nuk janë në nivelin e kënaqshëm, kështu që edhe krahas rekomandimit që të shpeshtohet prania dhe vizitat e bashkëpunëtorëve të jashtëm, gjatë vizitës për rikontroll, u konstatua se ky rekomandim nuk është zbatuar.

Pas realizimit të vizitës së rregullt të paparalajmëruar në vitin 2016, Avokati i Popullit konstatoi mungesë të kuadrit të angazhuar me punë nga të gjitha profilet, dhe në këtë kontekst

dërgoi rekomandim deri te Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të veprojnë konform Kërkesave për punësime të reja në IP Enti Special Demir Kapi dhe të mundësohen punësime të kuadrit të nevojshëm shtesë.

Sipas Avokatit të Popullit, pranimi i vazhdueshëm i shfrytëzuesve të ri në Institucion është në kundërshtim me politikën dhe principin e deinstitutionalizimit të parashikuar në “Strategjinë nacionale për deinstitutionalizimin e sistemit të mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë 2008-2018”, me ç’rast e sugjeroi nevojën e domosdoshme që të vazhdojë procesi i deinstitutionalizimit, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Enti Special të ndërmarrin aktivitete konkrete për përgatitjen dhe vendosjen e shfrytëzuesve në familjet biologjike ose në formë tjetër të mbrojtjes jashtë-institucionale, si dhe në mënyrë aktive të zbatohen masat për realizimin e deinstitutionalizimit.

Në përgjigjen ndaj rekomandimit Ministria e Punës dhe Politikës Sociale njoftoi se me qëllim të zbatimit të vazhdueshëm të procesit të deinstitutionalizimit është përpiluar Plan veprimi për zgjerimin e rrjetit të njësive banesore për personat me aftësi të kufizuar, në përputhje me të cilat planifikohet hapja e 21 njësive banesore në të cilat në formë të organizuar do të jetonin edhe 105 persona me aftësi të kufizuar të zhvillimit mendor. Në këtë kontekst, për vitin 2017 planifikohet hapja e 3 njësive banesore shtesë për 15 shfrytëzues, në vitin 2018 planifikohet hapja e 5 njësive banesore për 25 shfrytëzues, në vitin 2019 planifikohen 6 njësi banesore për 30 shfrytëzues, për vitin 2020 planifikohet 1 njësi banesore për 5 shfrytëzues ndërsa gjatë pesë viteve të ardhshme, gjithashtu, edhe nga një njësi banesore për nga 5 shfrytëzues.

Avokati i Popullit konstatoi se gjatë 5 viteve të fundit, mbi asnjë nga shfrytëzuesit që kanë ndërruar jetë në Institucion nuk është kryer obduksioni dhe sugjeroi që në rast të paraqitjes së vdekjes së pazakontë tek shfrytëzuesit, Qendra për punë sociale, përkatësisht drejtoria e Entit Special duhet të kërkojë të kryhet obduksioni, në mënyrë që të konstatohet shkaku i vdekjes. Gjithashtu, shqetëson edhe konstatimi se në institucion nuk ka ndarje të shfrytëzuesve sipas gjinisë, kështu që në një hapësirë qëndrojnë edhe personat e gjinisë mashkullore edhe të gjinisë femërore, e që është në kundërshtim me Programin dhe aktivitetet e Entit Special Demir Kapi.

Gjithashtu, konstaton se ushqimi shërbehet në trapezari të improvizuara të cilat gjenden në korridore, fill pranë nyjave sanitare, e që paraqet rrezikshmëri reale për transmetimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive. Në këtë kontekst, rekomandon që trapezaritë të vendosen në vend adekuatë ku shfrytëzuesit do ta konsumonin ushqimin në kushte të cilat do t'i përmbushin standardet kryesore sanitare, hapësinore dhe shëndetësore dhe njëkohësisht do të shmangej edhe rreziku për bartjen e infeksioneve dhe sëmundjeve ngjitëse.

Kushtet jashtëzakonisht të këqija të qëndrimit nuk i përmbushin minimum standardet për funksionimin e institucionit të këtij lloji (erë e fortë e padurueshme e urinës, nivel i ulët i higjienës, gjendje e keqe e nyjave sanitare dhe mosfunksionim i toaleteve, shfaqje e një numri të madh të insekteve dhe lagështisë dhe ngjashëm), dhe për këtë shkak është e domosdoshme të përmirësohet niveli i higjienës dhe gjendja me nyjat sanitare dhe në përgjithësi kushtet materiale në Institucion, përmes renovimit të Institucionit dhe përmes punësimit të më shumë pastrueseve të cilat do të kujdeseshim për mirëmbajtjen e higjienës.

Krahas kësaj, Avokati i Popullit – Mekanizmi Parandalues Nacional gjatë vizitës së realizuar në Ent në vitin 2016 konstatoi paraqitjen e morrave tek shfrytëzuesit, si dhe numër të madh të insekteve në të gjitha pjesët e Entit Special, përfshirë këtu edhe kuzhinën. Pamundësi për zbatimin adekuat të terapisë fizikale, për shkak se salla për terapi fizikale është jashtë përdorimit dhe për këtë shkak edhe ky lloj i terapisë zbatohet në hapësirat e vendosjes. Vite me radhë, ashensori është jofunksional dhe për këtë shkak shfrytëzuesit nuk kanë mundësi ta realizojnë të drejtën e shëtitjeve në ambient të hapur dhe mbeten të robëruar në hapësirat e katit në “objektin e ri”. Mungojnë aktivitetet sportive, kreative dhe edukative, si dhe ekskursionet, vizitat dhe manifestimet me karakter kulturor-argëtues. Shfrytëzuesit nuk janë përfshirë në kurrfarë punësh, përkatësisht aktivitetet okupacional në përputhje me aftësitë e tyre fizike dhe mendore.

Neni 24 – Arsimi

Avokati i Popullit konstaton se nuk janë të dukshme ndryshimet për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuar në realizimin e të drejtës së tyre të arsimit. Nga hulumtimi

nacional, të cilin e zbatoi Avokati i Popullit në vitin 2016, për shkallën e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuar në shkollat fillore (u përfshinë 325 shkolla fillore), rezulton se korniza ligjore dhe një pjesë e akteve relevante nënligjore të Republikës së Maqedonisë nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të dhëna në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, si dhe deklaratën e Salamancës.¹²

Në këtë kuptim, aftësia e kufizuar mungon si bazë për diskriminim në Ligjin për arsimin fillor dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore të cilët kanë të bëjnë me arsimin, ndërsa inkluzioni më shumë promovohet në mënyrë deklarative, me ç'rast fitohet përshtypja se inkluzioni është përjashtim, ndërsa ndarja është rregull.

Sipas Avokatit të Popullit, korniza ligjore në Republikën e Maqedonisë tanimë është orientuar kah aftësia e kufizuar e fëmijëve si kategori mjekësore dhe kah adresimi i problemeve të cilat rezultojnë nga e njëjta, në vend se kah potenciali i fëmijëve dhe aftësive të tyre.

Mungon sistemi arsimor i përshtatshëm i diverstitetit dhe nevojave të çdo fëmije (përshtatje e arsyeshme), kështu që fëmijët karakterizohen dhe regjistrohen në institucionet arsimore në përputhje me ato kategorizime, me çka kategorizimi mjekësor mbetet dokument kyç për rrugëtimin e mëtutjeshëm të fëmijës përmes sistemit arsimor edhe në kushte të ekzistimit të shkollave speciale (të cilat ndërlidhen me një lloj të caktuar të aftësisë së kufizuar) dhe paraleleve në shkollat e rregullta (të cilat gjithashtu ndërlidhen me kategorizimin mjekësor), nuk mund të bëhet fjalë për sistem unik të arsimit.

Avokati i Popullit, nga puna e tij, konstatoi se në kornizën ligjore dhe nënligjore mungojnë zgjidhjet të cilat fëmijët dhe interesin më të mirë të tij e vendosin në qendër të vëmendjes dhe në këtë mënyrë edhe mungesa e sistemit për mbështetje gjatë gjithë shkollimit. Po ashtu, mungon ndryshimi efikas dhe i plotë (ligjor) për mbështetje në arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar, si dhe është e pamjaftueshme edhe mbështetja institucionale e inkluzionit si në nivel të kapaciteteve (ekzistimi faktik i institucioneve përkatëse, njohurive dhe

¹² https://www.unesco.de/fileadmin/medien/Dokumente/Bildung/Salamanca_Declaration.pdf

shkathtësive dhe qasja deri te institucionet ekzistuese), ashtu edhe në nivel të organizimit (komunikimi midis institucioneve, ndarja e të drejtave dhe përgjegjësisve, synim në vend të orientimit funksional).

Fragmentimi institucional e pengon fëmijën me aftësi të kufizuar për fitimin e arsimit kualitativ dhe ndihmës së specializuar, ndërkohë që mungojnë njohuritë, shkathtësitë dhe veprimi i koordinuar në nivel institucional në drejtim të interesit më të mirë dhe arsimit përkatës inkluziv të fëmijës me aftësi të kufizuar.

Vendosja e fëmijëve me aftësi të kufizuar në paralele të ndara (të veçanta) në shkollat e rregullta, nga një numër i madh i mësimitdhënësve trajtohet si inkluzion edhe pse praktika tregon se ata fëmijë ose nuk kanë fare kontakte ose kanë kontakte minimale me fëmijët e tjerë. Shkollat nuk janë të pajisura në mënyrë përkatëse sa i përket aspektit kadrovik dhe teknik për zbatimin e inkluzionit të fëmijëve me aftësi të kufizuar në arsimin e rregullt fillor. Gjithashtu, mungojnë trajnimet përkatëse dhe të vazhdueshme të kuadrit mësimitdhënës në shkolla për punë me këta fëmijë dhe nisur nga kjo mungon edhe përmirësimi i kualitetit të arsimit të cilin e fitojnë. Së këtejmi, nevojitet sensibilizim më i madh i të punësuarve në shkolla për gjendjen me këta fëmijë, si dhe mungon rëndësia e përfshirjes së tyre, ndërsa notimi/testimi i njohurive dhe shkathtësive të fituara të fëmijëve me aftësi të kufizuar nuk është përshtatur dhe nuk është pasqyrë efikase për njohuritë e tyre.

Përveç kësaj që u tha më lartë, Avokati i Popullit konstatoi se inkluzioni në arsimin e mesëm pasqyrohet në implementimin e improvizuar e që paraqet pasojë të të kuptuarit dhe interpretimit sipërfaqësor të inkluzionit. Mungesa e harmonizimit ligjor dhe zbatimit konsequent të ligjeve ekzistuese, përgatitja e pamjaftueshme e kushteve në shkolla dhe kuadrit për punë me nxënës me aftësi të kufizuar, ekipet profesionale të pakompletuara, niveli i ulët i vetëdijes për nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuar, ndikojnë mbi krijimin e mundësive të barabarta arsimore për të gjithë. Shpeshherë në shkolla sigurohen masa të pakompletuara dhe zbatimi i tyre paraqitet vetëm si “pro formë” e që nuk rezulton me efekte pozitive. Mungesa e standardeve të përcaktuara qartë për inkluzionin çon në pritshmëri të ulëta dhe dukshmëri joreale për inkluzionin si proces.

Ky konkluzion bazohet në konkluzionet konkrete si vijojnë: Korniza ligjore nuk është harmonizuar tërësisht me dispozitat e dokumenteve kryesore ndërkombëtare të kësaj fushe. Kjo e përfshinë të drejtën e regjistrimit (qasjes) të nxënësve me aftësi të kufizuar në arsimin e mesëm të rregullt. Mungon mekanizmi për identifikimin, evidentimin dhe monitorimin sistemor të nxënësve me aftësi të kufizuar në arsimin e mesëm të rregullt. Nga njëra anë, në masë të madhe kjo i zvogëlon mundësitë e tyre arsimore, ndërsa nga ana tjetër, e vështirëson planifikimin e politikave arsimore. Mbështetja për inkluzionin është kryesisht deklarative. Nuk sigurohen mjete të mjaftueshme buxhetore për mbështetjen e inkluzionit të nxënësve me aftësi të kufizuar në arsimin e mesëm të rregullt. Edhe pse qasja në arsim kryesisht kuptohet në kuptimin fizik, madje as ajo nuk është siguruar në masë të kënaqshme. Kryesisht, bëhet fjalë për sigurimin e rampës së aksesshme në ndërtesën e shkollës, së këtejmi duke i shpërfillur standardet, megjithatë shumë pak bëhet për qasjen në hapësirat e brendshme dhe mjetet didaktike, përkatësisht pajisjen e shkollave për mësim inkluziv. Krahas përvojave pozitive nga pilotimi i zbatimit të teknologjisë ndihmëse (rezultat i iniciativës të sektorit civil), roli i teknologjisë bashkëkohore informacionit-komunikimit si mjet për inkluzionin arsimor është shpërfillur thuaja se tërësisht. Nuk aplikohen mjete dhe materiale të aksesshme didaktike, si dhe nuk janë të aksesshëm librat shkollor dhe materialet e tjera arsimore të alfabetit të Brail-it, në audio format ose konform standardeve për akses në ueb-faqe. Nuk ekziston as kornizë përkatëse juridike për këtë çështje. Mësimdhënësit nuk disponojnë me njohuri dhe shkathtësi në aspekt të punës me nxënës me aftësi të kufizuar dhe individualizimin e mësimin. Vështirësi të veçantë u shkakton zhvillimi dhe aplikimi i planeve individuale arsimore dhe vlerësimi i nxënësve të cilët punojnë sipas planit individual arsimor. Nuk ekziston qasje e unifikuar ndaj kësaj çështje.

Kjo që u potencua më lartë, rezulton nga hulumtimi i Avokatit të Popullit i zbatuar në vitin 2017 për përfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuar në arsimin e mesëm të rregullt. Mes tjerash, konstatohet se ekipet inkluzive shkollore nuk kanë rol dhe kompetenca mjaftueshëm të qarta. Formimi i tyre, për momentin, është kryesisht i karakterit formal. Në mënyrë plotësuese, zgjidhja aktuale ligjore (e cila e përcakton obligimin për formimin e ekipeve inkluzive shkollore) i referohet asaj se ekipet e këtilla duhet të formohen në shkolla të mesme të posaçme. Vërejmë mbështetje të pamjaftueshme për inkluzionin tek publiku i përgjithshëm

dhe profesional. Njëri nga efektet është mosshfrytëzimi i shkollave të posaçme dhe kapaciteteve të tyre në funksion të qendrave të resurseve për mbështetjen e inkluzionit në arsimin e rregullt. Nuk ekzistojnë mekanizma për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira midis shkollave, ekipeve profesionale dhe mësimeve. Nuk ekzistojnë mekanizma as për shkëmbimin e informatave dhe koordinimin midis dy niveleve të arsimit (për shembull, arsimin fillor dhe të mesëm). Nuk ekziston vetëdije e mjaftueshme për nevojat, mundësitë dhe aftësitë e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkolla, publikun më të gjerë dhe më të ngushtë. Është vërejtur pjesëmarrje shumë e ulët e nxënësve me aftësi të kufizuara arsimore dhe familjeve të tyre, në proceset të cilat parapëlqejnë pjesëmarrjen e tyre aktive si partnerë: vlerësim i aftësive, mundësive dhe nevojave, krijim i planit arsimor individual dhe përshtatje e mjedisit jetësor dhe resurseve. Nxënësit me aftësi të kufizuar arsimor përfaqësohen minimalisht me pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet jashtë-mësimore.

Sa i përket arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar, shpeshherë nga prindërit paraqiten parashtrësia me peticione për transferimin e fëmijës me aftësi të kufizuar nga klasa ku mësojnë fëmijët të cilët nuk kanë aftësi të kufizuar, në mënyrë që të mos e “pengojnë” arsimimin e fëmijëve të tjerë. Avokati i Popullit konsideron se nevojitet angazhim më i madh i shërbimeve profesionale në shkollë për punë me të gjithë fëmijët, programet dhe aktivitetet për respektimin e diversiteteve.

Neni 25 / neni 28 – Shëndeti

Nga takimet me prindërit e fëmijëve/personave me Paralizë Cerebrale, Sindromën Daun, si dhe prindërit e fëmijëve me dëgjim të dëmtuar, rezultoi konstatimi se ballafaqohen me qasje të vështirësuar deri te të drejtat e mbrojtjes shëndetësore dhe sigurimit shëndetësor, më saktësisht të sigurimit të pajisjeve ortopedike.

Avokati i Popullit pas pranimit të informatës se këta persona nuk mund ta realizojnë të drejtën e pajisjeve ortopedike, për shkak të mos-përmbushjes së kushteve të përcaktuara me dispozitat e Rregullores për indikacionet e të drejtës së pajisjeve ortopedike dhe pajisjeve të tjera (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 84/2012) – akt nënligjor të cilin e miraton Fondi për Sigurim Shëndetësor, dhe i cili si kusht parashikon sigurim shëndetësor pa ndërprerë gjashtë mujor, konstatoi cenimin e të drejtave të fëmijëve në përgjithësi të cilët kanë nevojë për pajisje

ortopedike. Sipas Avokatit të Popullit, mbrojtja e shëndetit dhe parandalimi i pasojave të dëmshme mbi shëndetin e fëmijëve duhet të jetë prioritet në veprimin e organeve dhe institucioneve, me ç'rast deri te Fondi për Sigurim Shëndetësor dërgoi Rekomandim që të analizohen dispozitat e Rregullores për indikacionet e të drejtës së pajisjeve ortopedike dhe pajisjeve të tjera ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 84/2012), dhe të rishqyrtohet kushti i cili parashikon sigurim shëndetësor pa ndërprerë 6 mujor në mënyrë që fëmija të mund të fitoj pajisje ortopedike, ndërsa me Informatë të veçantë e njoftoi edhe ministrin për Shëndetësi për miratimin më të shpejtë të ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për sigurim shëndetësor, me çka personat e siguruar do të mund t'i realizojnë të drejtat për pajisje ortopedike dhe pa kushtëzime ta përmbushin kushtin prej gjashtë muajve të cilin e parashikon Ligji.

Avokati i Popullit, gjatë vitit 2016, i hulumtoi gjendjet në institucionet e specializuara psikiatrike në Shkup, Negorci dhe Demir Hisar, me qëllim të konstatimit të gjendjeve me realizimin e të drejtave të personave me sëmundje mendore, konform Ligjit për shëndet mendor. Janë vërejtur probleme me gjendje të pa-standardizuara në institucionet shëndetësore të specializuara për shëndet mendor, para së gjithash kushte të këqija të vendosjes, mungesë të kuadrit, veçanërisht të personelit profesionalë – mjekë, infermiere, sanitare dhe edukatore, si dhe me mungesën e personelit, veçanërisht në IPSH Spitalin Psikiatrik në Shkup, ku nga viti 2009 janë vakantë 100 vende të punës. Higjiena në ambientet është në nivel të kënaqshëm edhe pse për shkak të amortizimit një pjesë e objekteve nga aspekti arkitektonik, nuk mund të pritet të kenë kushte më adekuate higjienike.

Nga vizitat e realizuar dhe gjendjet e përcaktuara u konstatua se nuk ekziston strategjia për shëndet mendor si dokument strategjik i cili i rregullon çështje e hospitalizimit dhe trajtimit të kësaj kategorie të pacientëve. Nevojitet miratimi i programit të veçantë për riparimin dhe rekonstrukcionin e objekteve dhe hapësirave në të cilat qëndrojnë dhe mjekohen pacientët, si dhe të vendosen standarde për edukimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të personelit dhe më gjerë, në drejtim të ngritjes së vetëdijes publike për shëndet mendor. Konstatimet e Avokatit të Popullit, nga hulumtimi në terren dhe rekomandimet lidhur me të njëjtat, janë përfshirë në Informatën gjithëpërfshirëse e cila u është dërguar organeve kompetente.

Sipas Avokatit të Popullit miratimi i Strategjisë së re nacionale për shëndet mendor, do të krijoj parakushte për vazhdimin e procesit të de-institucionalizimit dhe përforcimin e parandalimit në sferën e shëndetit mendor. Mes tjerash, për riparimin e kushteve të këqija, veçanërisht në repartin e meshkujve të Spitalit Psikiatrik Shkup, Avokati i Popullit rekomandoi që urgjentisht të ndërmerren masa edhe në drejtim të riekipimit kadrovik përkatës të institucioneve shëndetësore të specializuara, veçanërisht në ISHP Spitali Psikiatrik Shkup.

Gjatë vitit 2016 me intervenimin e Avokatit të Popullit, fëmijët me çrregullime endokrinologjike e vazhduan mjekimin me terapinë e njëjtë, përkatësisht hormonin për rritje. Përkatësisht, Klinika për Sëmundjet e Fëmijëve, në marrëveshje me Ministrinë e Shëndetësisë, vendosi që në tenderin për furnizim të specifikoj vetëm terapi të ngjashme hormonale biologjike për të gjithë fëmijët të cilët kanë sëmundje endokrinologjike. Pas informatave të pranuar se ndryshimi i terapisë mund të shkaktoj kundër-indikacione serioze dhe efekte anësore për shëndetin e fëmijëve, Avokati i Popullit dërgoi rekomandim dhe kërkoi marrjen e masave përkatëse me qëllim të sigurimit të vazhdueshëm dhe papengesë të mbrojtjes shëndetësore dhe krijimit të kushteve që fëmijët të vazhdojnë me terapinë e njëjtë – hormon për rritje me të cilin trajtohen që nga fillimi i mjekimit, pa u inkorporuar ndryshime të cilat mund të shkaktojnë pasoja të padëshirueshme për shëndetin dhe jetën e tyre.

Neni 27 – Puna dhe punësimi

Hulumtimi i zbatuar nga Avokati i Popullit për realizimin e të drejtës së punësimit të personave me aftësi të kufizuar në vitin 2012¹³ tregoi se ndonëse ka kornizë të mirë ligjore dhe nënligjore mungon implementimi i saj konsekuent dhe i plotë praktikë. Po ashtu, në praktikë këta persona ballafaqohen me stereotipa dhe paragjykime gjatë realizimit të të drejtës së punësimit, ndërkohë që nuk janë të informuar mjaftueshëm as punëdhënësit dhe personat të cilët kërkojnë punë për të drejtën, obligimet dhe përgjegjësitë të cilat rezultojnë nga marrëdhënia e punës. Është konstatuar edhe ekzistimi i pakënaqësisë nga organet të cilët kryejnë mbikëqyrje dhe për këtë shkak personat me invaliditet janë dekurajuar sa i përket paraqitjes së keqpërdorimeve nga ana e punëdhënësve, ndërsa pakënaqësi ka edhe për

¹³ Tryezë e rrumbullakët me temë: “Punësimi i personave me invaliditet, gjendjet dhe sfidat”, viti 2012, www.ombudsman.mk

shkak të procedurave të gjata për vendimmarrje të Komisionit për dhënien udhëzimeve dhe mendimeve si gjatë punësimit të parë, ashtu edhe gjatë ndërrimit të vendit të punës.

Mes tjerash, ky hulumtim tregoi se organet kompetente nuk kanë të dhëna të plota për të drejtën e punës dhe punësimin e personave me invaliditet mbi të gjitha bazat dhe veçanërisht sepse mungon evidenca e vetme për personat me invaliditet të cilët janë të aftë për punë, për numrin e personave të cilëve u është ndërprerë marrëdhënia e punës mbi bazë të ligjit, por edhe në rastet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në kundërshtim me ligjin. Njëherësh, komunikimi i vështirësuar midis personit me invaliditet-punëdhënës-organ-institucion varësisht nga pengesat në zhvillimin e personit dhe për këtë shkak se është më i ngadaltë dhe jo i plotë socializimi i personave me invaliditet. Gjithashtu, nevojitet hapja e administratës për punësimin e këtyre personave. Pikërisht për këtë, është e nevojshme të krijohen kushte dhe mundësi për punësim, përkatësisht rritje të numrit të personave me invaliditet, në të ashtuquajturat Shoqëri Tregtare Mbrojtëse, por edhe në administratën shtetërore.

Avokati i Popullit, duke e monitoruar gjendjen me të drejtën e punësimit të personave me aftësi të kufizuar (invaliditet), ndërsa pas shpalljes së konkursit për themelimin e marrëdhënies së punës me kohë të pacaktuar të gjithsej 300 realizuesve (persona me invaliditet) dhe duke vepruar sipas parashtresave të parashtuara nga këta persona për shkak të zvarritjes së procedurës për themelimin e marrëdhënies së punës, në vitin 2016 zbatoi hulumtim për realizimin e të drejtës së punësimit të personave me aftësi të kufizuar, pas shpalljes së konkursit në NP “Pyjet e Maqedonisë”-Shkup¹⁴. Temë e hulumtimit ishte perceptimi i gjendjes me realizimin e të drejtës së punësimit të personave me aftësi të kufizuar (invaliditet), sipas konkursit të shpallur në fund të muajit tetor 2013 nga ana e NP “Pyjet e Maqedonisë”-Shkup. Për këtë qëllim u përpilua Pyetësori dhe Tabela të cilat iu dërguan NP “Pyjet e Maqedonisë”-Shkup, Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratë dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale. Së këtejmi, konstatoi se procedura e përgjithshme për punësimin e një numri më të madh të realizuesve (persona me invaliditet) është me dobësi të shumta. E njëjta nuk është përpiluar dhe konceptuar mirë, si dhe nuk është realizuar me

¹⁴ Raport i posaçëm, www.ombudsman.mk

kohë. Para publikimit të shpalljes së Konkursit nuk është përcaktuar nevoja reale për punësimin e këtyre realizuesve në organet e nivelit shtetëror dhe lokal, por përcaktimi pasoi në mënyrë plotësuese. Ekziston mospërputhje midis Konkursit dhe vendet e lira të punës. Një numër më i madh i personave me invaliditet, të drejtën e punësimit e kanë realizuar ngadalë dhe me vështirësi, ndërkohë që akoma ka persona të cilët nuk e kanë realizuar të drejtën. Edhe pse periudha nga rankimi i kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet deri në transferimin ose punësimin e tyre ishte parashikuar të zgjasë nga 4-6 muaj, edhe pas 3 vjetësh nga konkursi i zbatuar, një numër i konsiderueshëm i realizuesve nuk janë punësuar, nuk realizojnë pagë dhe kontribute të pagës, si dhe nuk kanë as sigurim social. Për shkak të mos-konkretizimit/mos-saktësimit të datës për lëshimin e Udhëzimit dhe mendimit nga komisionet kompetente në Konkurs, personat me invaliditet në mënyrë plotësuese janë referuar ta përcaktojnë llojin dhe shkallën e aftësisë së kufizuar, si dhe të aftësisë për kryerjen e detyrave të caktuara të punës para disa organeve/komisioneve. Avokati i Popullit, gjithashtu, konstatoi mos-koordinim midis organeve/institucioneve (NP “Pyjet e Maqedonisë”-Shkup, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë) të ngarkuara për zbatimin e Programit të Qeverisë për punësimin e 300 realizuesve (persona me invaliditet), në dëm të kandidatëve për punësim. Rrjedhimisht me këtë, Avokati i Popullit paraqiti rekomandime, ndërsa raportin e plotë e publikoi në ueb-faqen e tij dhe publikun e informoi edhe përmes Raportit vjetor.

Në praktikë nuk janë krijuar supozime reale për shfrytëzimin papengesë të kësaj të drejte mbi bazë të barabartë me të tjerët, duhet vënë në dukje se për shkak të nevojës për përshtatje përkatëse ndaj punëtorëve me aftësi të kufizuar nuk ka disponim për punësimin e tyre. Në këtë drejtim është edhe nevoja për promovimin e modelit të punësimit të mbështetur, dhe jo vetëm punësim mbrojtës i cili funksionon në Republikën e Maqedonisë, në të cilin ekziston mungesa e mbështetjes në vet rrjedhën e punës, përkatësisht personi i punësuar nuk mund ta ruaj punën ose nuk mund ta realizoj punësimin.

Sipas Avokatit të Popullit, me qëllim të realizimit papengesë të kësaj të drejte, shteti duhet të ndërmerri hapa serioz, me masa konkrete dhe të vazhdueshme, me qëllim të punësimit të këtyre personave në të gjitha organet/institucionet/organizatat, dhe jo vetëm në

shoqëritë tregtare mbrojtëse, përkatësisht të krijojnë dhe ofrojnë edhe mundësi të tjera për zhvillim dhe kualifikim të personave me aftësi të kufizuar.

Gjatë punësimit të këtyre personave, sipas tyre, gjithashtu duhet të respektohet qasja individuale, në përputhje me mundësitë dhe kapacitetet e personit me aftësi të kufizuar, si dhe të ndërmerren masa efikase nga ana e kompetentëve për identifikimin dhe sanksionimin e punësimeve fiktive dhe keqpërdorimet e punësimeve të personave me aftësi të kufizuar.

Neni 28 – Standardi adekuat jetësor dhe mbrojtja sociale

Pengesa gjatë realizimit të të drejtave të mbrojtjes sociale, siç është shtesa për mobilitet, verbëria dhe shurdhëria, Avokati i Popullit i konstatonte sipas parashtrësive të parashtruara, ndërsa qytetarët pas intervenimit të tij i realizonin pranë qendrave kompetente për punë sociale dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Në këtë kontekst, edhe pse në një numër më të vogël, nga përmbajtja e të njëjtave u konstatua se fëmijët/personat me aftësi të kufizuar ballafaqohen me pengesa për shkak të mos-vendosjes në afat të parashikuar, edhe pse individualisht, pas intervenimit të Avokatit të Popullit, ndërmerreshin masa dhe parashtruesit e realizonin të drejtën.

Avokati i Popullit konstatoi se prindërit e fëmijëve/personave me aftësi të kufizuar i dinë të drejtat e kompensimit në para, por edhe se lartësia e kompensimit nuk është e mjaftueshme për mbulimin e nevojave të fëmijëve/personave. Në këtë drejtim është edhe pakënaqësia që rezulton nga gjendja me qendrat ditore dhe format e tjera të përkujdesjes dhe mbështetjes së fëmijëve/personave me aftësi të kufizuar.

Në takimet me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar, por edhe me fëmijët/personat, si dhe gjatë vizitave të tyre te Avokati i Popullit theksohet se në mungesë të qendrave për përkujdesjen dhe vendosjen e fëmijëve/personave konform aftësisë së kufizuar, shumica e prindërve, për shkak të nevojës për përkujdesje 24 – orë për fëmijën nuk mund të themelojnë marrëdhënie pune, me çka gjendja e rrezikut në të cilin gjenden përkeqësohet akoma më shumë.

Sidomos, pakënaqësia dhe ndjenja e pabarazisë shprehet përmes Ligjit për mbrojtje sociale, i cili mundëson vendosjen dhe përkujdesjen e këtyre fëmijëve/personave në familjet

kujdestare, me ç'rast familja merr kompensim mujor për shpenzimet për personin e vendosur dhe për përkujdesjen, ndërsa ata si prindër nuk fitojnë. Fëmijët/personat me Sindromën Daun kanë nevojë për shoqëruar i cili do t'u ndihmojë që të lëvizin më lehtë, përkatësisht të orientohen në hapësirë, por edhe fizikisht t'u ofrojnë mbështetje për shkak të specifikës së gjendjes në të cilën ndodhen. Në mungesë të qendrave ditore për përkujdesje, përkatësisht vendit ku mund të kalojnë një pjesë të caktuar të kohës së tyre përmes aktiviteteve sociale dhe llojeve të tjera të aktiviteteve, prindërit njoftojnë se vite me radhë nuk e dinë se si është të dalin dhe të relaksohen, të vizitojnë teatër, kinema dhe ngjashëm sepse janë të detyruar të qëndrojnë 24 orë pranë fëmijëve të tyre.

Sipas Avokatit të Popullit shteti duhet të sigurojë forma përkatëse të banimit të pavarur për fëmijët/personat me aftësi të kufizuara me ndihmën e asistentit, si dhe të sigurojnë ndihmëse të prindërve të cilët kanë nevojë për një gjë të këtillë, me çka edhe ata do të mund të planifikojnë aktivitete të lira (vizita në teatër, kinema, pushim dhe ngjashëm), pa pasur frikë se kush do të kujdeset për fëmijët e tyre, mundësi e cila realizohet dhe është reale në vende të caktuara.

Avokati i Popullit vizitoi një numër të madh të qendrave ditore për persona me aftësi të kufizuara, me ç'rast përveç përfitimeve të konstatuara pozitive dhe ndihmës së madhe për këta persona dhe për familjet, megjithatë janë konstatuar edhe probleme të caktuara me të cilat gjatë punës së tyre përballen këto qendra ditore. Është konstatuar se në këto qendra ditore nuk ka çdoherë mjete materiale për zhvillimin normal të aktiviteteve dhe detyrave të nevojshme dhe se ballafaqohen me problemin e mungesës së kuadrit përkatës profesional, me mjetet materiale dhe teknike.

Vizitat në qendrat ditore, mes tjerash, konfirmuan se funksionimi i këtyre qendrave është zgjidhje e mirë, sepse bëhet rehabilitimi dhe socializimi i këtyre personave, stimulohet pjesëmarrja e tyre aktive në jetën shoqërore. Njëkohësisht, me pranimin e personave me aftësi të kufizuara stimulohet dhe ofrohet mbështetja për tejkalimin e gjendjeve me izolimin social të këtyre personave, me qëllim të adaptimit më të lehtë të tyre në mjediset e reja, si dhe janë vërejtur ndryshime pozitive në sjelljen e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe, mes tjerash, tek fëmijët/personat zhvillohen shkathtësi dhe aftësi të caktuara, rritet pavarësia personale, aftësia

e punës dhe komunikimit, motorikës dhe gjuhës, si dhe ngrihet vetëdija për sjellje përkatëse dhe të drejtë ndaj personave me aftësi të kufizuar.

Avokati i Popullit pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe pranë Ministrisë së Shëndetësisë paraqiti Iniciativë për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për vlerësimin e nevojave specifike të personave me aftësi të kufizuar, në zhvillimin fizik ose psikik, sepse zgjidhjet ekzistuese normative, të parashikuara me këtë Rregullore, në praktikë i pengojnë fëmijët/personat e sëmurë me Fibrozë Cistike ta realizojnë të drejtën e shtesës së veçantë si kompensim në para, për shkak se kjo sëmundje nuk ishte përfshirë, përkatësisht nuk ishte përfshirë në nenin 9 paragrafin 1 të Rregullores për vlerësimin e nevojave specifike të personave me aftësi të kufizuar në zhvillimin fizik ose psikik.

Duke e marrë parasysh situatën dhe problemin e cekur me të cilin ballafaqohen pacientët me Fibrozë Cistike, Avokati i Popullit kërkoi ndryshimin dhe plotësimin e kësaj rregulloreje dhe Fibroza Ciste të përfshihet në grupin e formave më të rënda të sëmundjeve kronike, me çka personat e sëmurë nga kjo sëmundje do të kenë qasje papengesë deri te e drejta e shtesës së veçantë si kompensim në para dhe njëkohësisht të shqyrtohet mundësia që e drejta e kësaj shtese në para t'u njihet edhe të rriturve me Fibrozë Cistike, përkatësisht personave mbi 26 vjet.

Kërkesa e Avokatit të Popullit u pranua, ndërsa Rregullorja u ndryshua, kështu që sëmundja Fibrozë Cistike u përfshi në grupin e formave më të rënda kronike, me çka fëmijëve u mundësua realizimi i të drejtës së pranimit të kompensimit në para.

Neni 30 – Pjesëmarrja në jetën kulturore, rekreacion, pushim dhe sport

Fëmijët/personat me aftësi të kufizuar nuk janë përfshirë sa duhet në jetën kulturore të komunitetit, ndërsa prezenca e tyre varet nga mundësitë e prindit/kujdestarit. Fëmijët me aftësi të kufizuara të lehta në zhvillim, të cilët janë përfshirë në sistemin arsimor në kuadër të programit mësimor, marrin pjesë në disa lloje të aktiviteteve sportive dhe rekreative, e që nuk është rast edhe me fëmijët e tjerë në varësi nga aftësia e kufizuar. Nga ana e komunitetit është theksuar nevoja për angazhim më të madh të bashkësive lokale për vizita të organizuara të

manifestimeve për të gjithë fëmijët në mënyrë të barabartë, mes tyre edhe fëmijët me aftësi të kufizuar, stimulimi i pjesëmarrjes në ngjarjet sportive dhe rekreative përmes sigurimit falas të shërbimeve të objekteve të caktuara, me çka do të rritet pjesëmarrja e këtyre fëmijëve/personave në sport dhe rekreacion, do të ndryshohet vetëdija tek fëmijët e tjerë dhe personat me aftësi të kufizuar, përkatësisht do të kontribuohet në drejtim të pranimin më të madh të diversiteteve. Gjithashtu, nevojitet përshtatje e programeve me të cilat këta fëmijë/persona do të mund të përfshihen në aktivitete sportive dhe rekreative, si dhe të ndërmerren masa për realizimin e këtyre të drejtave të fëmijëve/personave të cilët jetojnë në vende rurale ku mundësitë për realizimin e këtyre të drejtave, në masë të madhe, janë të kufizuara.

Sipas Avokatit të Popullit, respektimi i realizimit të të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar duhet të bëhet në drejtim të krijimit të kushteve për sigurimin e jetës së përshtatshme, bazuar mbi barazinë dhe mosdiskriminimin dhe, në këtë kuptim, është e nevojshme të dëgjohen dhe të merren parasysh mendimet e tyre, si dhe të krijohen kushte për pjesëmarrje në komunitet dhe kontribut në ndërtimin e shoqërisë, në të cilën në mënyrë të barabartë sigurohen të drejtat dhe liritë e njeriut, trajtimi i barabartë i diversiteteve, me respektimin dhe marrjen në konsideratë të dinjitetit të njeriut. Avancimi, mbrojtja dhe siguri i personave me aftësi të kufizuar në mënyrë të plotë dhe të barabartë t'i gëzojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe ta promovojnë respektimin e dinjitetit të tyre, në fakt, ky është edhe qëllimi kryesor i Konventës për të Drejtat e Personave me Invaliditetet, si dhe i Konventës për të Drejtat e Njeriut.

Krahas kësaj që u tha më lartë, Avokati i Popullit konsideron se është e nevojshme që në vazhdimësi të ndërmerren masa në të gjitha sferat e jetës shoqërore, me qëllim të ngritjes së vetëdijes për aftësinë e kufizuar dhe zhvillimin e shërbimeve inkluzive, dhe në këtë mënyrë pranimin se fëmijët/personat me aftësi të kufizuar kanë nevojë për qasje të individualizuar. Parimi i pjesëmarrjes dhe inkluzionit duhet të mundësoj angazhim (përfshirje) të këtyre personave në shoqëri, veçanërisht gjatë miratimit të vendimeve për ta dhe për të drejtat e tyre, me ç'rast personat të cilët nuk janë me aftësi të kufizuar (nevoja të veçanta) duhet të manifestojnë gatishmëri dhe transparencë për përfshirjen dhe pranimin e tyre.

IV. Statistika

Në shtojcën e kësaj pjese, Avokati i Popullit ia dërgon Komitetit Pasqyrën tabelore të parashtrësive të parashtruara sipas viteve dhe sipas fushave, në të cilat parashtruesit kanë kërkuar mbrojtjen e të drejtave si persona me aftësi të kufizuar dhe për të cilat Avokati i Popullit ka vepruar që nga ratifikimi Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

| ПРЕГЛЕД НА ПРИМЕНИ ПРЕТСТАВКИ | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|-------------|------------|-------------|------------|-------------|------------|-------------|------------|-------------|------------|-------------|------------|-------------|------------|-------------|------------|-------------|------------|-------------|------------|--|
| | 2008 | | 2009 | | 2010 | | 2011 | | 2012 | | 2013 | | 2014 | | 2015 | | 2016 | | 2017 | | |
| | Број | % | Број | % | Број | % | Број | % | Број | % | Број | % | Број | % | Број | % | Број | % | Број | % | |
| Недискриминација и соодветна и правична застапеност | 21 | 0,69 | 20 | 0,55 | 16 | 0,4 | 42 | 0,99 | 32 | 0,74 | 51 | 1,35 | 66 | 1,55 | 53 | 1,2 | 69 | 1,83 | 70 | 2,17 | |
| Полициски овластувања | 236 | 7,81 | 252 | 6,94 | 238 | 5,89 | 179 | 4,21 | 220 | 5,06 | 177 | 4,68 | 173 | 4,07 | 156 | 3,54 | 133 | 3,52 | 152 | 4,71 | |
| Граѓански состојби и други внатрешни работи | 132 | 4,37 | 154 | 4,24 | 169 | 4,18 | 126 | 2,96 | 156 | 3,59 | 97 | 2,57 | 85 | 2 | 90 | 2,04 | 45 | 1,19 | 53 | 1,64 | |
| Правосудство | 883 | 29,22 | 744 | 20,5 | 757 | 18,7 | 732 | 17,2 | 710 | 16,34 | 732 | 19,37 | 901 | 21,2 | 850 | 19,32 | 577 | 15,28 | 576 | 17,87 | |
| Социјална заштита | 115 | 3,81 | 95 | 2,62 | 140 | 3,46 | 193 | 4,53 | 240 | 5,52 | 206 | 5,45 | 279 | 6,57 | 382 | 8,67 | 245 | 6,49 | 157 | 4,87 | |
| Работни односи | 253 | 8,37 | 389 | 10,7 | 365 | 9,03 | 412 | 9,68 | 306 | 7,04 | 246 | 6,51 | 299 | 7,04 | 265 | 6,02 | 155 | 4,11 | 199 | 6,17 | |
| Станбени односи | 34 | 1,13 | 57 | 1,57 | 89 | 2,2 | 65 | 1,53 | 57 | 1,31 | 76 | 2,01 | 36 | 0,85 | 42 | 0,95 | 48 | 1,27 | 11 | 0,34 | |
| Здравствена заштита | 69 | 2,28 | 72 | 1,98 | 93 | 2,3 | 115 | 2,7 | 166 | 3,82 | 128 | 3,39 | 125 | 2,94 | 79 | 1,79 | 83 | 2,2 | 101 | 3,13 | |
| Пензиско и инвалидско осигурување | 180 | 5,96 | 181 | 4,98 | 159 | 3,93 | 237 | 5,57 | 241 | 5,55 | 224 | 5,93 | 221 | 5,2 | 175 | 3,97 | 135 | 3,58 | 138 | 4,28 | |
| Образование, наука, култура и спорт | 39 | 1,28 | 49 | 1,35 | 48 | 1,19 | 45 | 1,06 | 35 | 0,81 | 34 | 0,9 | 21 | 0,49 | 41 | 0,93 | 29 | 0,77 | 17 | 0,53 | |
| Права на децата | 145 | 4,8 | 157 | 4,32 | 111 | 2,75 | 144 | 3,38 | 161 | 3,7 | 116 | 3,07 | 124 | 2,92 | 158 | 3,59 | 106 | 2,81 | 119 | 3,69 | |
| Урбанизам и градба | 162 | 5,36 | 170 | 4,68 | 170 | 4,2 | 146 | 3,43 | 155 | 3,57 | 140 | 3,7 | 168 | 3,95 | 168 | 3,81 | 165 | 4,37 | 158 | 4,90 | |
| Животна средина | 15 | 0,5 | 21 | 0,58 | 20 | 0,49 | 26 | 0,61 | 35 | 0,81 | 20 | 0,53 | 26 | 0,61 | 16 | 0,36 | 15 | 0,4 | 22 | 0,68 | |
| Финансии | 48 | 1,59 | 50 | 1,38 | 71 | 1,76 | 101 | 2,37 | 130 | 2,99 | 106 | 2,8 | 407 | 9,58 | 865 | 19,64 | 1039 | 27,52 | 510 | 15,82 | |
| Имотно-правни односи | 317 | 10,49 | 361 | 9,94 | 401 | 9,92 | 360 | 8,46 | 272 | 6,26 | 261 | 6,9 | 239 | 5,62 | 224 | 5,09 | 174 | 4,61 | 125 | 3,88 | |
| Потрошувачки права | 147 | 4,86 | 277 | 7,63 | 553 | 13,7 | 673 | 15,81 | 948 | 21,81 | 646 | 17,09 | 486 | 11,44 | 368 | 8,36 | 309 | 8,19 | 282 | 8,75 | |
| Казнено-поправни и воспитно-поправни | | | 347 | 9,55 | 395 | 9,77 | 352 | 8,27 | 278 | 6,4 | 247 | 6,53 | 274 | 6,45 | 257 | 5,84 | 198 | 5,25 | 264 | 8,19 | |
| Деца и лица со посебни потреби | | | | | | | | 10 | 0,23 | 10 | 0,26 | 11 | 0,26 | 9 | 0,2 | 15 | 0,4 | 5 | 0,16 | | |
| Попис | | | | | | 12 | 0,28 | 3 | 0,07 | | | | | | | | | | | | |
| Избирачки права | | | | | | 90 | 2,11 | | | 42 | 1,11 | 78 | 1,84 | 2 | 0,05 | 65 | 1,72 | 25 | 0,78 | | |
| Друго | 226 | 7,48 | 236 | 6,5 | 248 | 6,13 | 206 | 4,84 | 191 | 4,39 | 221 | 5,85 | 230 | 5,41 | 203 | 4,61 | 170 | 4,5 | 240 | 7,44 | |
| ВКУПНО: | 3022 | 100 | 3632 | 100 | 4043 | 100 | 4256 | 100 | 4346 | 100 | 3780 | 100 | 4249 | 100 | 4403 | 100 | 3775 | 100 | 3224 | 100 | |